

LIGJ
Nr.8375, datë 15.7.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8093, DATË 21.3.1996 "PËR REZERVAT UJORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Industrisë, Punëve Publike dhe Transporteve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" bëhet ky ndryshim:

Në fund të nenit 15 shtohet fjalia:

"Përfshihet nga kjo kërkesë Shërbimi Hidrometeorologjik Publik".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2165, datë 23.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani